



Pranimar / Dorëzuar Prenjemo / Protato Received / Delivered		03.02.23		viti god year
Organ / Njesia Org. / Jedinica Org. / Unit	Hi. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shifra Protog. Appendix	Sasia Kohëzina Quantity	
SKM/SHK	1376/2023		118	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1135/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare Arben Mehmeti- Kryetar dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtare, dhe Avdyl Bektoshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1135/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me Nr. 1737/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtores të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.1135/2022 e datës 09.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. *Mbetet në fuqi* Vendimi me Nr. 1737/2022 i datës 11.11.2022 i Zëvendësueses së Drejtores të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil më datë 09.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7833/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 147/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtores të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimet për shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 09.12.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 26.01.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7883/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 1737/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtores të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Emailin të datës 27.09.2022 nga ankuesi për Sh.L; Emailin zyrtar të datës 26.09.2022 për ankuesin Sh.H; Emailin të datës 24.08.2022 nga ankuesi për Sh.L; Emailin të datës 17.06.2022 nga ankuesi për Sh.L; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 8275/2022 të datës 21.12.2022; Emailin zyrtar të datës 25.01.2023 për KPMSHCK; Emailin zyrtar të datës 19.01.2023 për Sh.L; Formulari i përshkrimit të punës pa datë; Emailin zyrtar të datës 28.09.2022 për Z.K; Emailin zyrtar të datës 27.09.2022 nga Sh.L për A.F; Emailin zyrtar të datës 27.09.2022 nga ankuesi për Sh.L; Emailin zyrtar të datës 26.09.2022 për ankuesin dhe E.H; ; Raportin e vençat të Komisionit të Ristrukturimit me numër protokolli 1620 të datës 01.11.2022; Përshkrimi i vendeve të punës "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa ZKF; Konkursi me Nr. Reference RN00006214 për pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm; Përshkrimi i detyrave të punës Drejtor i Arkivit Nder Komunal në Prishtinë të datës 08.02.2012; Titulli i vendit të punës " Udhëheqës/e i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut; Përshkrimi i detyrave të punës "Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Koordinim e Nismave Rajonale"; Përshkrimi i detyrave të punës Drejtor i drejtorisë së Administratës të datës 05.11.201; Përshkrimi i detyrave të punës Udhëheqës i autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore (Kodi:AI/030) të datës 23.05.2019;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE**:

Nga vlerësimi i provave të lëndës rezulton së më Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës.

Me tej, nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë (tutje DMZP-ja) është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në MPJD ka njoftuar individualisht ankuesen së në rastin konkret të ristrukturimit do të aplikohen dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur se në bazë të Akt Emërimit me Nr. Ref: 1053/2014 të datës 16.07.2014 ankuesi ka qenë i punësuar në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës* në Ministrinë e Diasporës, ndërsa sipas Rregullores Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kjo pozitë nuk është paraparë, mirëpo në kuadër të Departamentit për Diplomaci Ekonomike janë paraparë dy divizioni: Divizioni për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve dhe Divizioni për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar. Meqenëse këto pozita kanë pësuar ndryshime sa i përket kualifikimeve të posaçme respektivisht njohjes së gjuhës së huaj (angleze), po ashtu edhe pozitat e tjera të lira të kategorisë së ulët drejtuese kanë paraparë kualifikime të posaçme, atëherë Komisioni i Ristrukturimit nuk ka mund të emëroj ankuesin në një pozitë të kategorisë së njëjtë brenda ministrisë për arsye se i njëjti nuk ka plotësuar kushtet e posaçme për pozitat përkatëse, ndërsa është rekomanduar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë transferimin në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Ankuesi më datë 22.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër A.nr.723/2022 ka kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen e ankuesit.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas vendimit të Këshillit me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, ka shqyrtuar çështjen e rastit të ankueses dhe në bazë të Raportit të veçantë të punës me numër protokolli 1620 të datës 01.11.2022, ka konstatuar se ankuesi nuk mund të sistemohet përkatësisht të transferohet në ndonjë pozitë të lirë brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak që nuk ka plotësuar kushtet e pozitave respektivisht kushtet e posaçme formale, duke propozuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që i njëjti të transferohet në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Koordinimin e Nismave Rajonal* në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 10.11.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.147/2022 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Koordinimin e Nismave Rajonal* në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr. 147/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se procedura e transferimit është bërë në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse për pozitën e Divizionit për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve dhe Divizionit për Bashkëpunim Ekonomik

Ndërkombëtar kualifikimet e posaçme janë jo parimore, andaj ka kërkuar shfuqizimin e Vendimit me Nr. 147/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të rekomandohet Sekretari i Përgjithshëm i MPJD të më sistemon në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, me të cilin është përcaktuar se: *"1.Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës"* dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson së ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizmit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit kanë pësuar ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës. Nisur nga ky fakt, Kolegji konstaton se si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës, është bërë riorganizimi i këtyre dy ministrive i materializuar më Rregullores Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe si rrjedhojë e riorganizimit ka pas shuarje të pozitave të caktuara të punës, krijim të pozitave të reja të punës si dhe ndryshime të kriterëve për pozita të caktuara. Gjegjësisht, ndërlidhur me këtë Kolegji i Këshillit duku u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të miratuar nga DMZP-ja lidhur me pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit ka pas ndryshime të kriterëve të punës përkatësisht janë përcaktuar kriteret shtesë lidhur me kualifikimet e veçanta duke vendosur si kriter *njohjen e gjuhës angleze*, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton së nuk është i bazuar pretendimi ankimor se nuk janë plotësuar kushtet e ankuesit për transferim.

Andaj lidhur me pretendimin ankimor se aprovimi i kriterëve të veçanta për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve është i kundërligjshme jo parimore, Kolegji ju referuar dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht nenit 18 paragrafi 2 me të cilin është përcaktuar se: *2. Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkesat për zotërimin e arsimit që përfshin nivelin dhe fushën e arsimit, kualifikimin apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për atë pozitë përkatëse (psh. provimin e jurisprudencës apo ndonjë certifikim tjetër), përvojës profesionale domethënëse në profesion dhe/apo në punë apo kushteve të tjera specifike (psh. zotërimi një certifikimi për një gjuhë të huaj, etj., si dhe nenit 19 me të cilin është paraparë se: Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozitës së punës. 2. Përshkrimi i punës shërben për: 2.1. të njohur nëpunësin civil me punën që duhet të kryejë; 2.2. vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës; 2.3. vlerësimin e rezultateve në punë; 2.4. përcaktimin e kërkesave të veçanta për çdo pozicion pune në shërbimin civil. 3. Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen*

institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucionit...." andaj, mbi këtë bazë ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson së çdo organizimin i brendshëm i një institucioni publik ndiqet dhe përcaktohet nga misioni dhe fushëveprimi i tij kushtetues apo ligjor, kështu që nisur nga ky konstatim, e duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, sipas të cilit Ministria e Punëve të Jashtme është dikaster qeveritar përgjegjës që të zbatoj politikën e jashtme të Republikës së Kosovës si dhe të përfaqësoj Republikën e Kosovës dhe institucionet e saj shtetërore në vendet e jashtme dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare, rrjedhë së njohja e gjuhëve të huaja është e nevojshme për ushtrimin e këtyre funksioneve, andaj vendosja e kualifikimeve të posaçme lidhur me një pozitë në pajtim me specifikat e institucionit është ligjërish i bazuar.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, konstaton se për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve si kualifikime të posaçme formale janë paraparë: *Njohje e gjuhës angleze në nivelin B2-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze.* Në kuptim të plotësimit të kriterëve për këtë pozitë të punës, Kolegji bazuar në shqyrtimin e dosjes personale të ankuesit ka gjetur së i njëjti ka plotësuar kriterin e arsimit dhe përvojës së punës por jo edhe kualifikimet e veçanta lidhur me njohjen e gjuhës angleze.

Kolegji i Këshillit po ashtu ka analizuar edhe kriteret lidhur me pozitat e kategorisë së ulët drejtuese që kanë qenë të lira në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në përfundim të ristrukturimit gjegjësisht për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Evropë dhe BE si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca Politike, Studime Evropiane, Juridik, Ekonomik, Shkenca tjera shoqërore me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës Angleze, Frënge ose Gjermane në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në këto gjuhë ose në një universitet jashtë vendit në këto gjuhë.* Udhëheqës i Divizionit për Amerikën Qendrore dhe Jugore si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca Politike, Juridik, Ekonomik, Filozofik, Filologjik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze ose spanjolle në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze ose spanjolle, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në këto gjuhë ose në një universitet jashtë vendit në këto gjuhë.* Udhëheqës i Divizionit për Organizatën e Kombeve të Bashkuar si kualifikime të posaçme janë përcaktuar *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Juridik, Ekonomik ose Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale Njohje e ndonjë prej gjashtë(6) gjuhëve zyrtare të OKB-së, në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera*

në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura. Udhëheqës i Divizionit për NATO si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca të Sigurisë, Juridik ose Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze ose frënge në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze ose frënge dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose frënge. Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca të Sigurisë, Shkenca Politike, Juridik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Kulturore dhe Sportive si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare: Arte, Gazetari, Shkenca Komunikimi, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Politike ose shkenca tjera sociale, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Publikë dhe Privilegje Diplomatike si kualifikime të posaçme janë përcaktuar; *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare: Gazetari / Shkenca komunikimi / Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Politike, Teknologji Informative ose shkenca tjera sociale, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale; Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Afrikën Nën-Sahariane si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Juridik, Ekonomik ose Shkenca tjera shoqërore, natyrore ose teknike, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze, frënge ose arabe në nivelin B2-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhëve angleze, frënge ose arabe, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në këto gjuhë ose në një universitet jashtë vendit në këto gjuhë. Udhëheqës i Divizionit për Azinë si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Diplomë/a të studimeve universitare, në Juridik, Ekonomik ose Shkenca tjera shoqërore, natyrore ose teknike, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin B2-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca të Sigurisë, Shkenca Politike, Juridik, Shkenca tjera shoqërore, me të*******

paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Promovimin dhe Përkrahjen e Investimeve si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në lëmin e ekonomisë, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin B2-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar, si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në lëmin e ekonomisë, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin B2-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze, Rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar së ankuesi nuk ka plotësuar kriteret e posaçme për asnjërën nga pozitat e lartshënuara, sepse pas ristrukturimit Komisioni i Ristrukturimit ka bërë përpjekjet maksimale që ankuesi të sistemohet brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, por meqë i njëjti nuk ka plotësuar kushtet konkretisht kualifikimet e posaçme për asnjë nga pozitat e nivelit të mesëm drejtues atëherë mundësia e vetme ka qenë propozimi për transferim në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, ashtu siç parashihet edhe me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil". Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e përgatitjes së raportit me numër protokolli 1620 të datës 01.11.2022 për rastin e ankuesit dhe propozimin për transferimin e ankuesit, ka vepruar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.147/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes të cilit ankuesi është transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Koordinimin e Nismave Rajonal në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ka konstatuar se ky vendim është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, duke marrë parasysh që përveç tjerash ankuesi posedon përgatitje profesionale në fushën në të cilën kërkohet për pozitën përkatëse ku është transferuar, andaj pretendimet e ankuesit ndaj këtij vendimi janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1135/2022

Avdyll BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së